

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ 96/19 dhe 110/19, si dhe në bazë të nenit 50 alinea 6 nga Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr.161/2019) Ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi programin e shkurtuar për lëndën *Arsimi teknik* për klasën e katërt të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

PROGRAM I SHKURTUAR MËSIMOR

# ARSIMI TEKNIK

Shtator 2020

**Klasa IV**

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT



## 1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor për vitin shkollor 2020/2021 nga lënda *Arsimi teknik* për klasën e katërt të arsimit fillor nëntëvjeçar bazohet në qëllimet/rrezultatet e pritura me programin mësimor për lëndën mësimore i cili në formë të rregullt realizohet në përputhshmëri me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar vërtetohen fushat programore dhe njësitë mësimore që do të duhet të realizohen për 159 ditë pune mësimore, gjatë së cilës duhet ruajtur fondi i paraparë javor i paraparë në programin e rregullt, konkretisht për lëndën mësimore me 1 orë mësimore në javë janë paraparë 320 orë me program të shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar bazohet nga qëllimet/ rrezultatet e pritura, nocionet, metodat dhe aktivitetet të parapara në programin e rregullt mësimor.

## 2. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

### TEMA: SHKRIMLEXIMI GRAFIK ( 10 ORË)

#### Njësi mësimore:

1. Organizimi i vendit të punës
2. Llojet e vijave
3. Vizatim të figurave me vija të ndryshme teknike
4. Nga idea deri te realizimi (skicë dhe vizatim teknik)
5. Skicim të idesë dhe përpunim të vizatimit
6. Matje (matje të dimensioneve të ndryshme: m, dm, cm, mm )
7. Matje me precizitet deri 1mm
8. Distancë dhe kotim
9. Kotim dhe zbatim të elementeve të kotimit në vizatim teknik
10. Vizatim të skicave dhe figura të rëndomta në kompjuter në PAINT

**TEMA: MATERIALE PËR NDËRTIM DHE FORMËSIM ( 10 ORË)**

**Njësi mësimore:**

1. Letra dhe gjysmëkartoni (përfitimi, llojet dhe veçoritë)
2. Veprimet e punës gjatë përpunimit të letrës dhe gjysmëkartonit
3. Riciklimi i letrës së vjetër
4. Tekstil (përfitimi, lëndë natyrore dhe artificiale, llojet dhe veçoritë)
5. Vepimet e punës gjatë punës me tekstil
6. Prerje dhe qepje me tekstil
7. Prodhime gjysmë druri
8. Llojet dhe veçoritë(karakteristikat) e gjysmëdrurit
9. Veprimet e punës gjatë përpunimit të drurit
10. Përpunim të objekteve nga materiale të kombinuara

**TEMA: KRIJIMI KONSTRUKTIV ( 6 ORË)**

**Njësi mësimore:**

1. Elemente për përbërje ( vida dhe kaçavida )
2. Montimi dhe çmontimi i modeleve dhe maketeve nga elemente të gatshme
3. Veprimet për konstruim të modeleve dhe maketeve dhe sqarimi i funksionit i origjinaleve.
4. Konstruimi i modeleve të ndryshme
5. Zbatimi praktik i origjinaleve
6. Montimi objekteve ( automobil, mullir ere, aeroplan, anije...)Склопување на објекти(возило, ветерница,авиониче, бротче...)

**TEMA: KOMUNIKACIONI ( 6 ORË)**

**Njësi mësimore:**

1. Rregulla dhe dispozita për lëvizje të këmbësorëve në komunikacion
2. Rregullim i udhëkryqit me shenja të komunikacionit
3. Sinjalizimi i ndritshëm i komunikacionit
4. Shenja komunikacioni ( rrugë me përparësi kalimi, udhëkryq, kalim për këmbësorë, ndalim i komunikacionit për këmbësorë )
5. Zgjidhje të detyrave dhe problemeve në komunikacion me shenja komunikacioni
6. Zbatimi i fotografive, modeleve, sllajdeve dhe programe në TIK për rregullim të komunikacionit.

### 3. Rekomandime didaktike

Pikënisje bazë për realizimin e programit të shkurtuar mësimor për vitin shkollor 2020/2021 për lëndën *Arsimi teknik* është programi i rregullt mësimor ( qëllimet konkrete, nocionet, aktivitetet dhe metodat e propozuara) të cilat japin mundësi për planifikim dhe realizim të njësive mësimore, sipas përparimit dhe nevojave të nxënësve, si dhe duke respektuar parimin e aktualizimit në mësimin e arsimit teknik.

Gjatë vëzhgimit, instruimit dhe demonstrimit nxënësit udhëzohen të përdorin veprime dhe instrumente për të zbatuar njohuritë e fituara në jetën e përditshme dhe praktikë.

Njësitë mësimore japin mundësi për integrim sipas qëllimi/eve dhe përmbajtjes me lëndët mësimore matematikë, arsim figurativ, shkencat natyrore dhe shoqëri.

Nevojitet që mësimdhënësi të përdorë metoda, forma, mjete mësimore dhe materiale përmes së cilave do tju mundësojë nxënësve të tregojnë aftësitë e tyre në procesin mësimor me pjesëmarrje aktive duke përvetësuar njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera të cilat do të mund ti shfrytëzojnë në jetën e përditshme.

Meqënëse aktivitetet e parapara në program ndonjëherë përfshijnë më shumë qëllime, si dhe qëllime nga përmbajtje të ndryshme apo fusha programore të ndryshme. Kështu që një qëllim mund të arrihet përmes aktiviteteve të ndryshme, derisa për zgjedhjen e aktiviteteve mësimdhënësi niset nga e njëjta, kushtet në mësonjtore, punëtori, materialet, mjeteve mësimore nga situata dhe çasje reale dhe simulative, nevojës së përparimit të të gjithë nxënësve duke pasur parasysh kohën e shkurtuar për realizim të orës mësimore.

### 4. Normativ për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhshmëri me normativin për kuadër arsimor i paraparë sipas programit të rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën *Arsimi teknik* për klasë të katërt të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021 e miratoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

---

Mila Carovska